



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR IDENTIFIKIMIN DHE SHENJËZIMIN E BANESAVE DHE
LOKALEVE NË PRONËSI KOMUNALE NË KUADËR TË OBJEKTIT TË NDËRTUAR ME
KONCESION

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për identifikimin dhe shenjëzimin e banesave dhe lokaleve në pronësi të Komunës të ndërtuara me Koncesion nga koncesionari: "NTP "Besa Komerc" objekti-ndërtesa në ngastrën kadastrale 1930, pronë e K.K Lipjan, rr."Lidhja e Prizrenit" (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon:

1. Lumnije Ejupi, Kryesuese, Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik
2. Hasan Zeqiri, anëtar, Zyra e Kryetarit të Komunës
3. Daut Reçica, anëtar, Drejtorati i Prokurimit
3. Bajram Sinani, anëtar, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
5. Ilir Shala, anëtar, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrër

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që bëjë identifikimin dhe shenjëzimin e banesave dhe lokaleve në pronësi komunale të ndërtuara me koncesion nga koncesionari "NTP "Besa Komerc".

Detyrat e cekura Komisioni është i obliguar ti kryej më së largu deri më 11.04.2016.

Pas përfundimit të punës së Komisionit, obligohet Sektori pronësoro-juridik që të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale në lidhje me regjistrimin e këtyre pronave në librat publike.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 260-14606
Lipjan, më 23.03.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

